

Analiza vjetore e Departamentit të Auditimit të Performancës

Në datën 29 janar 2020, Departamenti i Auditimit të Performancës këtu në KLSH, realizoi analizën vjetore në nivel departamental për punën përgjatë vitit 2019.

Analizën e hapi Kryetari i KLSH-së, z. Bujar Leskaj, i cili bëri një historik të shkurtër të rrugëtimit të performancës nga momenti i krijimit të departamentit, sfidat me të cilat është përballur ky departament në rritjen dhe konsolidimin e rolit të tij brenda dhe jashtë KLSH-së, si edhe objektivat për rritjen e mëtejshme në të ardhmen. Për vitin 2020, Kryetari Leskaj theksoi se departamenti duhet të gjenerojë 20% të punës totale audituese në nivel institucional dhe të rrisë impaktin dhe dinamikën me çështjet që trajton.

Në vijim, drejtori i departamenti z. Rinald Muça, bëri një analizë të arritjes së objektivave që parashtron Strategjia institucionale 2018-2022 për auditimin e performancës, me fokus tri drejtime kryesore: punën audituese, rritjen e kapaciteteve dhe impaktin në publik e palë interesi. Në krahasim me një vit më parë, performanca ka ulur numrin e auditimeve të lëvruara, por ka rritur cilësinë e gjetjeve, konkluzioneve e rekomandimeve, sikurse dhe impaktin në publik me 15 auditimet e tjera të publikuara.

Kjo analizë kishte në fokus “audituesin” si elementin kyç të suksesit departamental dhe, për të ndarë eksperiencat dhe arsyet e sukseseve e të dështimeve të deritanishme, fjalën e morën përgjegjësat dhe anëtarët e grupeve të auditimeve mbi “Performancën e MBZHR-së në akuakulturë”, “Performancën e institucioneve përgjegjëse për çerdhet dhe kopshtet”, “Efektiviteti i kasave fiskale” dhe “Zhvillimi i shërbimeve të kujdesit social”. Njëkohësisht, nga kolegët e departamentit u diskutuan çështje që lidheshin me përmirësimin e strukturës së raportit përfundimtar auditues, përmirësimin e kalendarit të trajnimeve në drejtim të përmbajtjes dhe formës së implementimit, nxitjen e debateve gjatë procesit auditues për të trajtuar dhe adresuar rigorozisht temat audituese, si edhe gjetjen e rrugëve për të menaxhuar më efektivisht kohën në dispozicion, në kushtet kur një pjesë e mirë e kolegëve ndjekin trajnime 5-mujore në institucione prestigjioze jashtë vendit (ECA, GAO, etj.) dhe subjektet jo gjithnjë janë eficiente në komunikim me KLSH-në.



Në mbyllje të analizës, dept. gjithashtu vuri theksin tek kontrolli i cilësisë për auditimet e kaluara dhe si duhet të përforcohet ai në të ardhmen, sikurse edhe tek diskutimi i dy botimeve më të fundit të KLSH-së mbi “Auditimet e vitit 2018 në performancë” dhe konferencën “Young ALSAI”.



Për 6-mujorin e parë të vitit 2020, dept. është i angazhuar në auditimet:

1. Masat administrative të Policisë së Shtetit në kundravajtjet rrugore;
2. Integrimi i Shqipërisë në BE;
3. Ndotja e menjëhershme e detit Adriatik (paralel me 5 SAI të vendeve që lagen nga Adriatiku);
4. Trajtimi i fëmijëve ndryshe;
5. Kurrikulat e sistemit parauniversitar;
6. Menaxhimi i mbetjeve plastike (paralel me 15 SAI që kanë marrë pjesë në Konferencën e organizuar për këtë qëllim në Poloni);
7. Efektiviteti i politikave qeverisëse në (e)migrimin e shqiptarëve;
8. Eficiensa e energjisë.

Të gjithë miqtë dhe dashamirësit e faqes sonë dhe të përmirësimit të performancës në administratën publike, janë të lutur të ndajnë me ne komentet dhe sugjerimet e tyre për çështjet e mësipërme dhe jo vetëm, në mënyrë që raportet tona t'i vlejnjë vërtet zgjidhjes së problematikave dhe rritjes së mirëqënies së qytetarit.